



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 15**

Datë: 13. 05. 2022. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Čemailj Kurtiši, Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**2. Aktivitetet e ZRPPC-së**

**3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ruajtjen e kutive të votimit të vendvotimeve të zgjedhjeve të lokale 2021, që kanë dallim në vota pas rinumërimit,

- Informatë Raport vlerësimi i nevojave të zyrave të ZLKZ (KKZ)

- Njoftim lidhur me zbatimin e projektit për Ditën Globale të Zgjedhjeve

-Shqyrtimi dhe miratimi i agjendës punëtori me Organizatat e Shoqërisë Civile të specializuara për zgjedhje, e përkrahur dhe financuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë”

-Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve për Strategjinë e Listës së Votuesve të KQZ-së

### **Këshilli për Buxhet dhe Financa**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit tremujor financiar, për periudhën 1 Janar -31 Mars 2022,
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të shpenzimeve të derivateve Janar -Mars 2022,

### **Të ndryshme.**

---

### **1.Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

( Nga këtu fillon incizimi i stenogramit.....) **Sami Kurteshi**, tha se: “...Është punë e brendshme, pak bëjmë kompromis, pak bëjmë lëshim, pak ata lëshojnë pe, vijnë te pika. Nëse në këso raste shkohet kështu, ky nuk është lëshim, është veprim i qëllimshëm....! Nuk po them kundër meje, ngase unë e kam kryer punën time dhe askujt si kam kërkuar llogari por, është veprim i qëllimshëm kundër vendimit të KQZ-së.”

**Alim Rama**, tha se unë nuk e di cili është versioni i fundit që ka shkuar në Kuvend sepse, ne nuk e kemi marrë versionin e fundit dhe ky është një dështim...Dhe, unë e pres ta marrë versionin e fundit....

Tash, duhet filluar masat disiplinore sepse, secili element i raportit ka qenë problematikë...

T’i lëmë të tjerat, por aktivitetet e KQZ-së nuk janë përmendë, sidomos aktivitetet me institucionet dhe personat ndërkombëtarë, e janë përmendë takimet protokollare me institucionet vendore. Unë pres nga Sekretariati të na tregohet se në bazë të cilit vendim, raporti është dërguar...! Ky raport, është i shkruar keq, janë përmendur nga kolegu “340” ndryshime, dhe KQZ në mënyrë unanime është pajtua, edhe sekretariati e ka pas problem me çka është pajtua... Edhe unë pres masat e mëtutjeshme...

**Sami Hamiti:** Është e vërtetë se në parim e kemi pranuar raportin, por me vërejtjet dhe plotësimet që duhet të bëhen, të inkorporohen...Tash, a duhet të ri inkorporohen ato pjesë që po kërkohen, një vendim ta marrim për herat tjera që të paktën, raporti të fillohet të punohet një muaj më parë dhe, ne të kemi kohë...

Nuk është krejt me e hudh raportin, ka raporte edhe më të dobëta...! Vërejtjet ekzistojnë, janë reale, dhe të shihet a mund të bëhen plotësime vërtetë, nëse jo herave tjera duhet ta kemi raportin së paku një muaj ma herët...

**Sami Kurteshi:** Unë, e kam raportin përfundimtarë që është dërguar në Kuvend...! Në variantin e tekstit ku i kam bërë vërejtjet, që për shembull në fq. 34, ka qenë një tabelë, tani në variantin e fundit tabela është në fq. 31. Kjo tabelë, as pas vërejtjeve, nuk është përmirësuar, nuk i ka shpjegimet! Tri herë e kam tërhequr vërejtjen për këtë tabelë, dhe nuk e kanë këqyrë, hiq nuk ju ka interesuar kjo punë...

Nuk janë bërë përmirësimet konkrete, e unë i kam theksuar vërejtjet...! I kam gjashtë variante, i ruaj, por kjo po më shqetëson se nuk janë fokusue në përmirësimin e raportit...

**Arianit Elshani:** Thanë parafolësit...! Është mirë që të kuptohet nga Sekretariati dhe nga të gjithë ata që janë të angazhuar në përgatitjen e këtij raporti, sepse çdo vendim i KQZ duhet të respektohet. Askush nuk e ka kontestuar kontributin e askujt në përgatitjen e këtij raporti, por mendoj që për herë të parë ne kemi pasur një raport përpara kohe një muaj në KOZ; rekomandoj që herave të tjera raporti të trajtohet në këshillin ligjorë dhe asnjëherë në KOZ.

Kontributi, është parë dhe komentin që unë e kam dhënë në mbledhjen e fundit lidhet pikërisht me atë që, vërtetë ato shprehjet e panevojshme, jemi dakorduar të hiqen por, duke mos u larguar kontributi i askujt... Pavarësisht, në çështjet si këto, të zhvishemi nga petku politik dhe të fokusohemi në përmbajtjet dhe fokusin që kemi...

E vlerësoj faktin se kemi pasur çasje pro aktive, kemi dhënë komente, vërejte dhe kam pritur që ato të merren për bazë. Varësisht nga vlerësimet, raporti reflekton punën tonë, dhe gjithçka të marrim si vetëkritikë për punën tonë, si funksionojmë ne, s'i i menaxhojmë ne punët tona qoftë si KQZ, dhe qoftë si Sekretariati...

**Ibrahim Selmanaj:** Nuk po flas në mënyrë të përgjithësuar, as të përmend emra, se kjo nuk më bënë përshtypje fare, pak punë është kjo se njerëzit ndërrohen por,

Sekretariati duhet ta marrë një mesazh të qartë: t'i respektojë vendimet e KQZ-së, t'i përfillë...

**Čemailj Kurtiši**: Faleminderit...! Me pak fjalë, edhe pse kam pasur pengesa në përkthim, por unë e kuptoj. Shkurt: propozojë që në të ardhmen, raporti të punohet me kohë, të kemi raport mujorë nga Sekretariati se çfarë ka punuar dhe në fund, ta ketë raportin e përmbledhur...

Mendoj që Sekretariati nuk ka vepruar me paragjykim, por për çdo rast, është dashur të të merren për bazë dhe të përmirësohen vërejtjet që kemi dhënë dhe ky është gabimi, sepse ne të gjithë kemi kërkuar që të përmirësohet përmbajtja...

Shumë herë jemi ballafaquar me materiale në momente të fundit, e kuptoj kur kjo ndodh por, në disa raste kemi mundur ta kemi materialin me kohë dhe të përgatitemi ne...Kur mundemi, s'kemi pse të vijmë në situatë para aktit të kryer. Duhet t'i nxjerrim konsekuencat, të dalim mirë, dhe të mos kemi situata të këtilla... Ky, është institucioni ynë që përcillet nga mediat, organizatat etj., dhe ne duhet të kemi kujdes..

## **2.Aktivitetet e ZRPPC-së**

**Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP-së**: Aktivitetet tona, i kemi përcjellë në emailat tuaj. Me ftesë të komisionit parlamentar për buxhet dhe transfere, zyrtarja jonë Mergita Kryeziu ka marrë pjesë në dëgjimin publik për ndryshim – plotësimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike.

Z. Hyseni, e njoftoi KQZ-në lidhur me takimin, si dhe me disa çështje specifike të diskutimeve në takim, e ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e partive politike, të organizatave të shoqërisë civile etj.

**Arianit Elshanit**, pyeti nëse ka një afat kohorë kur ne mund ti dërgojmë komentet si KQZ lidhur me projektligjin...

**Nexhmedin Hyseni**, tha se nuk kemi një afat të dhënë...

**Sami Kurteshi**, tha se, unë këmngulë që ne si institucion e kemi për obligim ti dërgojmë komentet, sugjerimet, vërejtjet sido që t'i quajmë...! Ne, e kemi përvojën, praktikën dhe ne nuk i dërgojmë... Nuk ka institucion më të thirrur, dhe më të

përgatitur... Ne kemi konflikte partiake, por ajo është 1%, kurse 99% ne kryejmë punë që janë të institucionit...

**Arianit Elshani**, propozoi që kjo të jetë prioritet, dhe të pezullohet puna me “rregulloret” dhe të marrë në konsideratë projektligjin dhe të përgatiten komentet e KQZ-së...

Në këtë pikë, diskutuan edhe **Kreshnik Radoniqi, Alim Rama dhe Nexhmedin Hyseni** i cili, shpjegoi se materiali që e diskutoi z. Rama, janë të ZRPP –së të përgatitura, pastaj **Sami Kurteshi, Ilir Gashi dhe Burim Ahmetaj**.

Në fund, u propozua që të formohet një grup dhe materiali të shqyrtohet në këshill, dhe mandej të diskutohet dhe të dërgohet në komisionin parlamentar...

#### **4. Raport i Këshillave të KQZ-së**

##### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ruajtjen e kutive të votimit të vendvotimeve të zgjedhjeve të lokale 2021, që kanë dallim në vota pas rinumërimit:

**Arianit Elshani**: KOZ, ka shqyrtuar këtë rekomandim. Bëhet fjalë për 289 kuti që rezultojnë nga auditimi, rinumërimi me vendim të PZAP-së dhe që po zhvillohet një proces. Dhe ne rekomandojmë për miratim.

Rekomandohet me 9 vota për...

2.Informatë: raport - vlerësimi i nevojave të zyrave të ZLKZ (KKZ):

**Arianit Elshani**: Është veç një informatë nga zyrtarët e ZLKZ-ve, në mënyrë që të shtyjmë përpara bashkëpunimin, çështjet logjistike, sfidat e ndryshme dhe mbështetjeve që KQZ do të bëjë për zyrtarët komunal. Është raporti, listimi i nevojave etj. KOZ, do ta përgatisë një agjendë e takimeve me kryetarët e komunave, si dhe detajet e tjera... Janë 35 zyre që gjenden në objekte publike, dhe 3 zyre në objekte private për të cilat, duhet të kemi parasysh sepse ata, duhet tashmë të largohen...

Në këtë pikë, diskutuan: **Sami Kurteshi**, tha se, e para, duhet parë gjendja e tyre, dhe e dyta, nëse do të ishte i nevojshëm një takim me zyrtarët e ZLKZ dhe të diskutohet gjendja e tyre e përbashkët; Pastaj, angazhimi i tyre gjatë kohës kur nuk ka zgjedhje ! Mendoj se duhet një plan për punën e tyre...

**Arianit Elshani**, tha se me plan të punës, tashmë ata janë duke u angazhuar në relacione të caktuara. Ai, e përkrahu një takim me kryesuesit e ZLKZ-ve. Pastaj, diskutuan edhe **Čemailj Kurtiši, Sami Hamiti, Burim Ahmetaj**, i cili kujtoi se rreth datës 6 qershor, do të jetë një takim me kryesuesit e ZLKZ-ve.

### 3.Njoftim lidhur me zbatimin e projektit për Ditën Globale të Zgjedhjeve:

**Arianit Elshani**, rikujtoi edhe njëherë aktivitetet e “Ditës globale të zgjedhjes” dhe e informoi KQZ-në me aktivitetet bazë në shënimin e kësaj dite, si dhe në rekomandimet që mund të dalin nga ky aktivitet, sidomos rreth strategjisë së informimit publik...

### 4.Shqyrtimi dhe miratimi i agjendës së punëtorisë me Organizatat e Shoqërisë Civile të specializuara për zgjedhje, e përkrahur dhe financuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë”:

**Arianit Elshani**, po ashtu tha se KOZ ka shqyrtuar agjendën e punëtorisë me Organizatat e Shoqërisë Civile të specializuara për zgjedhje, të përkrahur dhe të financuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë”. Ne, tha z. Elshani, e kemi edhe në agjendën e planit të KQZ-së dhe kjo e rritë aktivitetin e planifikimit, të komunikimit dhe të bashkëpunimit në raport me strategjinë ndaj komuniteteve, kategorive të ndryshme të votuesve, organizatave civile etj.

Në këtë pikë, diskutuan: **Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alim Rama, Sami Hamiti**.

Miratohet, në mënyrë unanime me ndryshime e konstatuar përgjatë shqyrtimit !

### Këshilli për Buxhet dhe Financa

#### 1.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit tremujor financiar, për periudhën 1 Janar -31 Mars 2022:

**Sami Hamiti**, tha se KB në mbledhjen e tetë, janë trajtuar dy raporte. Raporti i parë, është shqyrtuar dhe se Sekretariati ka raportuar se nga buxheti prej 5, 913, 951 euro, në kategorinë e pagave janë shpenzuar 271, 253 euro, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 26, 810 euro, dhe shpenzime komunale 4,278 euro. Subvencione dhe transfere, janë shpenzuar 1 milion e 50 000 euro.

Z. Hamiti, pati vërejtje në planifikim dhe shpenzim të mjeteve nga Sekretariati. Raporti, përndryshe është votuar në këshill në mënyrë unanime...

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, Burim Ahmetaj, Sami Hamiti, Miradije Meha (DAP), Arianit Elshani.

Në fund, raporti u miratua unanimit.

## 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të shpenzimeve të derivateve Janar -Mars 2022:

**Sami Hamiti**, tha se KB ka shqyrtuar detajisht shpenzimet e derivateve për muajt janar – mars 2022 por, dhe është diskutuar edhe propozimi që veturat për KQZ të merren me qira...

Në këtë pikë, diskutuan: Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Kurteshi dhe, Sami Hamiti.

Në fund, anëtarët e KQZ-së e miratuan unanimit raportin

## **5. Të ndryshme !**

**Čemailj Kurtiši**, diskutoi rreth lidhur me ID-të për anëtarët e KQZ-së, dhe tha se duhet të kërkohet në instancat më të larta, sipas ligjit që anëtarët e KQZ-së të pajisen me këto karta...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Ilir Gashi, Burim Ahmetaj, Sami Kurteshi lidhur me mënyrën, nevojën dhe faktin se ID-të, u takojnë anëtarëve të KQZ-së...